



VENDIM

Nr. 145 Datë 09.12.2013

**PËR
NDRYSHIMIN E RREGULLORES “MBI PROCEDURAT E EMËRIMIT
TË ADMINISTRATORIT DHE KOMPETENCAT E TIJ, NË ZBATIM
TË NENIT 18, PIKA 4/C TË LIGJIT NR. 9072, DATË 22.05.2003 “PËR
SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”, TE MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 1, DATE 10.1.2013, TE BORDIT TE KOMISIONEREVE
TË ERE-s DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROKURIMEVE TË
SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE SH.A**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 18 pika 4, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; nenit 19, të Rregullores mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 09.12.2013, mbasi shqyrtoi kërkesën e CEZ Shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm dhe relacionin e Drejtorive Teknike,

Vendosi:

1. Neni 12.4 i Rregullores ndryshohet si më poshtë:
“Për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve administratori zbaton Rregulloren e prokurimeve të kompanisë CEZ Shpërndarje Sh.a të miratuar nga ERE.
2. Miratimin e Rregullores së prokurimeve të shoqërisë CEZ Shpërndarje Sh.a. (bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.